

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsha Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve S. Sh. dhe E. V. që të dy nga Gjilani, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par 1 të KPK duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan P.nr. 64/2012 datë 23.12.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 64/2016 datë 23.02.2016 , në seancën e kolegjit të mbajtur më 14 qershor 2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit S. Sh., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan P.nr. 64/2012 datë 23.12.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 64/2016 datë 23.02.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan P.nr. 64/2012 datë 23.12.2015 i dënuari S. Sh. dhe E. V., janë shpallë fajtorë për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par 1 të KPK dhe për këtë vepër janë gjykuar: S. Sh., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj. Ndërsa E. V. me dënim me burgim

në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. Janë detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej nga 50 €. Pala e dëmtuar Banka Ekonomike qendrore në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil. Me të njëjtin aktgjykim, sipas dispozitivit II të aktgjykimit, në pajtim me dispozitën e nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK është refuzuar akuza për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par. 1 të KPPK meqë Prokurori i Shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale. Është vendosur që në këtë pjesë shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 64/2016 datë 23.02.2016.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, Sh. Sh., avokat nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozin që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të liro het nga akuza, ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.88/2016 datë 02.06.2016 ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par. 1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit, pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 dhe par. 2 nën par. 2.2 të KPPK sepse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, në të nuk janë dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, vlerësimi i provave nuk është bërë në pajtim me ligjin dhe nuk janë dhënë arsye se cilat fakte gjykata ka marr si të vërtetuara apo të pavërtetuara. Kurse në aktgjykimin e shkallës së

dytë nuk janë dhënë arsye për faktet relevante që kanë të bëjnë me pretendimet nga ankesa lidhur me shkeljen e ligjit penal.

Në fakt mbrojtësi i të dënuarit edhe me këtë mjetë juridik dhe bënë përsëritjen e pretendimeve nga ankesa, parafrazon dispozitat ligjore madje duke cituar pjesët e caktuara nga ankesa dhe duke bërë interpretimin e dispozitave ligjore, kurse fare pak jep shpjegime se ku konkretisht qëndrojnë shkeljet e pretenduara.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet e lartcekura nga fakti se aktgjykimet e kundërshtuara, pra edhe dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë janë të qartë dhe konkret. Në të janë dhënë arsye për të gjitha pikat e dispozitivit, pjesa ndëshkuese përmban të gjitha elementet e parapara me ligj si në pikëpamje të përshkrimit faktik ashtu edhe cilësimit juridik të veprës penale. Nga ana tjetër edhe aktgjykimi i shkallës së dytë është i qartë dhe konkret në të janë dhënë arsye për të gjitha faktet relevante madje edhe për pretendimet nga ankesa lidhur me shkeljen e ligjit penal siç ka paraqitur në faqen 5 ku konstaton se në rastin konkret meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Pjesa tjetër e kërkesës i referohet shkeljes së ligjit penal në dëm të dënuarit e cila shkelje, sipas pretendimeve të mbrojtësit konsistojnë në atë se në rastin konkret ligji më i favorshëm për të dënuarin ka qenë ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale respektivisht dispozita e nenit 339 par 3 të KPK, ndërsa është aplikuar ligji i ndryshuar tani i aplikueshëm respektivisht neni 442 par 1 të KPK.

Vlen të theksohet se këtu i dënuari fillimisht, me aktakuzën e ngritur më 30.11.2011 ka qenë i akuzuar për veprë penale shpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK. Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 16.12.2015, ka bërë ricilësimin e veprës penale duke i akuzuar të dënuarit akuzuar për veprat penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 të KPK, me që në ndër kohë është ndryshuar Ligji Penal ashtu që është dashur të aplikohet Ligji më i favorshëm për të dënuarit.

Gjykata Supreme, vlerëson të pabazuar pretendimin në fjalë për faktin se për veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK

(Kodi i vjetër), ka qenë i paraparë dënimi me burgim prej 1 deri në 8 vjet, ndërsa për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK (Kodi i aplikueshëm), dënimi me burgim prej 6 muajsh deri në 5 vite. Prandaj është e qartë se dispozita e nenit 422 të KPK është më e favorshme për të dënuarin sepse është paraparë dënimi më i butë siç drejtë kanë konkluduar të dy gjykatat.

Vendimin e saj lidhur me zhvillimin e ngjarjes dhe cilësimin juridik të veprës penale, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në një mori provash materiale dhe formale, në radhë të parë në mbrojtjen e të dënuarit S. Sh., të dhënë në Polici në prezencë të mbrojtësit, të cilin gjykata e ka marrë si kredibile meqë plotësisht përputhet edhe me prova tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor në veçanti në raportin special të auditorit të brendshëm të Bankës Ekonomike nr.11/11 datë 28.09.2011. I dënuari në mbrojtjen e tij në Polici e as më vonë, madje as në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk e ka mohuar faktin se shuma e parave prej 40.000€ është tërhequr në nga xhirollogaria e klientes së Bankës I. H. dhe është transferuar në xhirollogarinë N. V. Nuk ka qenë kontestues fakti I. H. kishte lidhur marrëveshje për afatizimin e shumës së parave prej 40.000 për normën e interesit vjetor prej 4% me të dënuarin E. V. si zyrtarë financiar, i Bankës Ekonomike filiali në Gjilan. Marrëveshja në fjalë nuk është evidentuar-futur në sistemin “...” dhe evidencën e afatizimit ditor. Shuma e cekur më lartë-mjetet e afatizuara, në mënyrë arbitrare është tërhequr nga i dënuari S. Sh. si menaxher i Bankës dhe, është transferuar në xhirollogarinë e N. V. – menaxher i mobilierisë “ “ në Gjilan, për të mundësuar shlyerjen e një borxhi të mëparshëm, pra në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i dënuari shpërdori detyrën detyrën zyrtare, prandaj konkludimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me rrjedhjen e ngjarjes dhe cilësimin juridik të veprës penale, për çfarë në aktgjykimin e shkallës së parë janë dhënë arsye të detajizuara, të cilat e ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë, e që si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga arsyerat e cekura më lartë, kjo Gjykatë ka refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml .nr. 127/2016 më 14 qershor 2016

Procesmbajtësja
Minire Xhambazi

Kryetari i kolegjit
Avdi Dinaj